

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ LOTUS FITNESS”**

Sot ne daten 05/02/2024

Z.Alban Shutina , I biri I Skenderit dhe I Fetije , i datelindjes 13.08.1977 , adresa : Tirane ,Njesia Administrative nr.5, 1023 identifikuar ne baze te ID me numer 030905020 , me numer personal H70813117L me aftesi te plota per te vepruar

I cili bazuar ne Ligjin Nr.9901 ,date 14.04.2008 **“Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare te Ndryshuar”**dhe nenet perkatese te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise ne fuqi , te cilet nepermjet ketij **Akt Themelimi** , themelojne Shoqerine **“LOTUS FITNESS”** e cila perbehet nga nenet e meposhtme

**KAPITULLI I**  
**FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI,SELIA, KOHEZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1. Shoqeria **“LOTUS FITNESS”** (ne vijim **“Shoqeria”** ) eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe nga legjislacioni ne fuqi.
- 1.2. Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3. Ky Statut eshte perpiluar ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emertimi**

Emertimi I Shoqerise eshte **“LOTUS FITNESS”** Sh.p.k.

**Neni 3 – Objekti I shoqerise**

**Aktiviteti kryesor I shoqerise eshte : Aktiviteti kryesor I shoqerise eshte : Palester ,**

**Neni 4 – Selia**

- 4.1. Selia e Shoqerise eshte **Tirane** Njesia Bashkiake nr.9, Bulevardi Zogu I, Pallati AGIMI, Kati II,
- 4.2. Transferimi I selise se Shoqerise ne nje vend tjeter behet me vendimin e Asamblese se Ortakeve.



4.3. Asambleja e Ortakeve mund te vendose, hapjen e filialeve, selive dytesore, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise, dhe jashte shtetit. Asambleja e Ortakeve mund t'ia delegoje kete competence organit administartiv.

#### **Neni 5 – Kohezgjatja e veprimtarise**

5.1. Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar ne kohe.

5.2. Shoqeria mund te prishet perpara ketij afati me vendim te Asamblese se Ortakeve.

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE.**

#### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

6.1. Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000( njeqindmije ) leke.

Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga 1 kuota te Kapitalit, me vlere nominale 100.000 ( njeqindmije ) leke.

6.2. Kapitali themeltar I shoqerise zoterohet nga

Z.AlbanShutina -100 %, 1 kuote me vlere nominale 100.000 leke

#### **Neni 7 – Rritja e kapitalit themeltar**

7.1. Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo moment, nje ose disa here, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Rritja e kapitalit behet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve. Vendimi I vlefshem merren vetem nese ortaket jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “.

#### **Neni 8 – Zvogelimi I kapitalit themeltar**

8.1. Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar. Zvogelimi I kapitalit behet me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve. Ne cdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar nga ligji.

8.2. Zvogelimi I kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

#### **Neni 9 – Transferimi I kuotave**

9.1. Transferimi I kuotave kushtezohet nga e drejta e parablerjes se ortakeve.

9.2. ne nje rast te tille, ortaku qe do te transferoje kuotat e tij ta kapitalit duhet ti njoftoje ortaket e tjere, me leter rekomande me kthim pergjigje dhe/ose me Leter Njoftim nepermjet adreses elektronike ( ne



vijim "Njoftimi"), (a) numrin e kuotave te ofruar ; (b) emrin e bleresit/perfituesit ; (c) cmimin e rene dakort per cdo kuote, I percaktuar ne cdo rast ne para, ose ne vleren ne para ne rastin e nje kundershperblimi tjeter te mundshem ( ne rast shkembimi, kompensimi vullnetar, transaksioni, dhe cdo rast tjeter transferimi me shperblim), ose vleren e objektit te transferimit ne rastin e transferimit pa shperblim; (d) modalitetet e pageses; (e) ftesen per te ushtruar te drejten e parablerjes. Afatet dhe kushtet e mundshme per te cilat eshte rene dakort midis transferuesit te kuotave dhe bleresit/perfituesit nuk do te jene detyruese per ortaket e tjere te cilet do te ushtrojne te drejten e parablerjes. E drejta e parablerjes I referohet te gjitha kuotave te kapitalit ofruar per shitje.

9.3. Ortaket do te kene ne dispozicion 30 (tridhjete) dite nga marrja e Njoftimit, per ti komunikuar ortakut qe transferon kuotat, synimin e tyre per te ushtruar apo jot e drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes.

9.4. Ne rast se oferta pranohet nga disa ortake, kuotat e ofruara nga ortaku qe transferon kuotat, do te ndahen nga ortaket pranues, ne te njejten mase me kuotat qe ata zotrojne, pervec rasti kur ka nje marreveshje te kundert. Ne asnje rast, pranuesi I ofertes nuk mund te ushtroje pjeserisht te drejten e parablerjes.

9.5. Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e ofruara ne njoftim mund tu transferohen te treteve sipas cmimit te specifikuar ne te.

### **KAPITULLI III**

#### **ASAMBLEJA, ADMINISTARTORET DHE EKSPERTET KONTABEL**

##### **Neni 10 – Asambleja e ortakeve dhe kopetencat e saj**

10.1. Organi vendim-marres I Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

10.2. Asambleja e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per ceshtjet vijuese: ndryshimet e statutit, emerimi dhe shkarkimi I administartoreve, eksperteve kontabel e likuidatoreve, zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit, transferimi I kupotave, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqerise, miratimi I bilancit dhe per cdo vendim tjeter parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni perkates.

##### **Neni 11 – E drejta e pjesmarrjes dhe e votes**

11.1. Cdo ortak ka te drete te marre pjese ne Asamble, te paraqes mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri I kuotave qe ai zotron.

11.2. Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjeter jo-ortak, I pajisur me procure me shkrim, me anen e se ciles mund te jape voten e tij.

11.3. Ortaku nuk mund te leshoje procure per votim vetem per nje pjese te kapitalit qe zotron.

##### **Neni 12 – Thirrja e Asamblese se Ortakeve, Kuorumi dhe Vendimet**

12.1. Asambleja e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit, Brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilancit, te raportit te Administartorit/ve, dhe /ose ekspertit kontabel (nese eshte emeruar) si dhe inventarit.



12.2. Asambleja mund te thirret ne cdo moment prej Administratorit me iniciativen e tij ose sipas kerkeses qe do ti drejtohet Administratorit nga nje ose disa prej ortakeve qe perfaqesojne te pakten 5 % ( pese perqind) te kapitalit themeltar. Asambleja thirret nepermjet : a) njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje, b) Faksit ; C) Poste elektronike.

Njoftimi me poste elektromike konsiderohet I kryer me kalimin e 10 (dhjete) diteve kalendarik nga nisja e njoftimit. Njoftimi per secilin ortak dergohet ne adresat respective pershkruar ne hyrje te ketij akti.

12.3. Lajmerimi do tu dergohet ortakeve, te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblese, mbi ceshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes.

12.4. Ne rast se Asambleja e Ortakeve nuk mblidhet me thirjen e pare per mungesen e kuorunit, Asambleja e Ortakeve do te thirret Brenda 15 (psesmbedhjete) ditesh me te njejtin rend dite.

12.5. Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet teleconferences, me kusht qe te gjitha pjesemarresit tem und te identifikohen dhe tu lejohet atyre te ndjekin diskutimin dhe te nderyjne ne momentin e trajnimit te ceshtjeve ne rend te dites; pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes.

12.6. Asambleja konsiderohet e mbajtur rregullisht nese Asambleja mblidhet ne seline e shoqerise. Asambleja konsiderohet se mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit e te vendmbajtjes ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.

12.7. Vendimet e Asamblese se Ortakeve, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zotrojne me shume se 51% (pesedhjete e nje perqind) te kapitalit themeltar.

12.8. Per drejtimin e puneve ne cdo Asamble zgjidhet nje kryetar, ortak ose ndonje person tjetër jo-ortak I caktuar nga vete Asambleja . Per pasqyrimin e vendim it Asambleja emerone nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo-ortak.

12.9. Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Ortaket.

### **Neni 13 - Njoftimi**

13.1 Njoftimi I ndersjellte ndermejt Administratorit , Perssonelit drejtues dhe bashkepunetoreve te shoqerise ,do te realizohet nepermjet :a)njoftimit me leter rekomande ,e kthim pergjigje ,b) Faksit,c)poste elektronike ,d)njoftimit ne faqen zyrtare elektronike te shoqerise

13.2 Njoftimi me poste elektronike konsiderohet I kryer me kalimin e 10( dhjete ) diteve kalendarike nga nisja e njoftimit .Njoftimi per secilin ortak dergohet ne adresat respective pershkruar ne hyrje te ketij akti.Administratori, personeli drejtues dhe bashkepunetoret e kontaktuar nga shoqeris duhet te depozitojne adresene tyre elektronike ne shoqeri.

13.3 Njoftimi nepermjet faqes zyrtare te shoqerise konsiderohet I kryer me kalimin e 10( dhjete ) diteve kalendarike nga publikimi I njoftimit ne faqenzyrtare elektronike te shoqerise .



#### **Neni14- Administrimi**

- 14.1 Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te ortakeve .
- 14.2 Perfaqesimi ligjor I shoqerise I besohet Z. AlbanShutina
- 14.3 Administratoret emerohen ne kete detyre per nje afat kohor 5( pese ) vjecar .
- 14.4 Administratori I shoqerise gezon te drejttat e administrimit te zakonshemshoqerise pa kufizime
- 14.5Administratori mund te emeroje perfaqesues te posacem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh

#### **Neni 15- eksperti kontabel I autorizuar**

- 15.1 Ne rast se kerkohet nga nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakeve ,kontrolli I bilanceve dhe librave kontabel te shoqerise mund ti besohet nje ose disa ekspoerteve kontabel te autorizuar .
- 15.2 Eksperti kontabel I autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

### **KAPITULLI IV**

#### **VITI FINANCIAR ,BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE**

##### **Neni16- Viti financiar dhe bilanci vjetor**

- 16.1 Viti fianaciar fillon ne 01 Janar dhe mbaron ne 31 Dhjetor te secilit vit
- 16.2 Bilancet vjetore , inventari, raportetm e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicen e kerkuar nga Ligji n.9901 te dates 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “
- 16.3 Miratimi I dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet Brenda 6( gjashte ) muajve qe nga fundi I vitit financiar

##### **Neni 17- Fitimet**

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor , u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara .
- 17.2 Asambleja mund te vendose zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo per shtyrjen e shperndarjes se fitimeve plotesisht ose pjeserisht , per vitet finaciara te ardhshme .

### **KAPITULLI V**

#### **SHPERNARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**



### **Neni 18- Prishja**

18.1 Shoqeria mund te prishet ne rastet e parashkuara nga ligji , ose me ane ten je vendimi te asamblese se Ortakeve , me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.

18.2 Shoqeria nuk prishet ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar , vdekjes ,ose falimentimit te ortakeve .

### **Neni 19- Likujdimi**

19.1 Ne rast prishje , Shoqeria duhet te likujdohet

19.2 Per te administruar kete procedure , Asambleja emeron nje ose me shume likujdatore te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise , mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likujdimin.

19.3 Me perfundimin e procedures se likujdimit , Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar , mbi punen e kryer nga likujduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likujdimit .

19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive , likuidatori do ti shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve , per proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar .

Per cfare nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohet legjislacioni ne fuqi

Statuti hartohet ne ne 3 kopje origjinale .Nje kopje depozitohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe kopjet e tjera ne seline ligjore te shoqerise .

### **ORTAKU I SHOQERISE**

#### **Z. ALBANSHUTINA**

ALBAN SHUTINA

